



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prodato Received/Delivery		18.04.2023	3 viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHIKU	3650/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.356/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.356/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesi çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 14.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.356/2023 e datës 14.02.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Formulari i datës 06.02.2023 për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesin.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Inspektoratin e Punës, më datë 14.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kudër vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Inspektorati i Punës. Ndërsa, Këshilli me datë 07.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 28.03.2023 ka nxjerr vendim VK/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë ditë (10) pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1733/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër 02/2021 të datës 19.04.2021 të ankuesit; Vendimin me numër të protokollit 1120/20 të datës 27.11.2020; Vendimin me numër të protokollit 531/2021 të datës 21.05.2021; Kërkesat e ankuesit lidhur me pushimet; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 06.02.2023; Komentet lidhur me vlerësimin të datës 09.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1930/2023 të datës 20.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2446/2023 të datës 07.03.2023; Formularin e vlerësimeve të rezultatit në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesës, i ulët dhe profesional të datës 28.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 04.02.2021; Raportet e ankuesit; Raportin mujor për muajin Dhjetor 2022; Raportin mujor për muajin Nëntor-2022; Raportin mujor Tetor-2022; Raportin mujor për muajin Shtator 2022; Raportin mujor për muajin Gusht 2022; Raportin mujor Korrik 2022; Raportin mujor Qershor 2022; Raportin mujor Maj 2022; Emalin e datës 10.03.2022 të drejtuar Emalin e datës 31.03.2022 të drejtuar Emalin e datës 15.04.2022 lidhur me raportin mujor të muajit Mars, të Inspektorëve të kampionit të Prishtinës 1/237 fq..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Inspektoratin e Punës, dhe se i njëjti sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit 02/02021 të datës 19.04.2021 ushtron pozitën e punës *Menaxher i Personalit*, në Inspektoratin e Punës.

Me tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të me datë 06.02.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022, me notë të përgjithshme 3.5.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon së vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është bërë në kundërshtim me Rregulloren Nr.21/2020 dhe shpërfillje të rëndë të gjendjes faktike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji mori parasysht dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. *Vlerësimi i*

rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit..... dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues., rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës rezulton së ankuesi për periudhën e parë të vitit 2022 lidhur me pjesën e përmbushjes dhe realizimit të objektivave të punës është vlerësuar më notë 3.3, ndërsa lidhur me pjesën e aftësive dhe shkathtësive profesionale është vlerësuar më notë 3.7, ku gjithsej nota e përgjithshme për këtë periudhë është 3.5.

Bazuar si me lart e në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 në paragrafi 1.4 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, nota përfundimtare e vlerësimit nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë", përkatësisht sipas këtij përcaktimi ligjor "shumë mirë", vlerësohet nëpunësi civil i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit, kështu që mbi këtë bazë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendosjen e notës së përgjithshme 3.5 për ankuesin, ka vlerësuar së i njëjti ka përmbushur të gjitha objektivat e punës, ka tejkeluar pritjet sipas këtyre objektivave dhe së i njëjti ka kontribuar edhe në performancën e përgjithshme të institucionit punëdhënës, andaj, si rrjedhojë janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit së vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është bërë më shkelje të dispozitave ligjore.

Nisur nga faktet si me lart, Kolegji i Këshillit konstaton së vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë



(30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.356/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.